



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1605/1 prot.

Tiranë më // .// .2021

Lënda: Dhënie mendimi për projektvendimet për krijimin e bazave të të dhënave shtetërore.

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 5609/4 prot., datë 01.11.2021, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimet “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar (SMIP)”, “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit të vlerësimit të maturës shtetërore (SVMSH)”, “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit të provimit të shtetit (SPSH)”, lutemi referojuni vlerësimit në vijim të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana juaj, si dhe nga analizimi i pikës 1, geramat “d”, “dh” dhe “e” të VKM nr. 371, datë 26.04.2017 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve” (i/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore) dhe të nenit 18 të Urdhrit nr. 365, datë 28.12.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e komisionit të provimit të shtetit dhe procedurat e zhvillimit të provimit të shtetit” (ku përcaktohen funksionet e QSHA-së), Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk është përcaktuar qartë baza ligjore që legjitimon përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale në këto baza të dhënash.

Në zbatim të parashikimeve të nenit 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe detyrimeve të përcaktuara në nenet 5, 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim “Ligji”), përpunimi i të dhënave duhet të bëhet vetëm nëse parashikohet me ligj.

Gjithashtu, nuk konstatohet se ka një akt tjetër ligjor që të legjitimojë aksesin e QSHA dhe institucioneve të tjera në Regjistrin e Gjendjes Civile. Për të aksesuar këtë Regjistër, duhet vepruar sipas parashikimit të pikës 1, të Udhëzimit nr. 463, datë 10.12.2020

“Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”, të Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit. Vetëm në këtë rast mund të legjitimohet aksesin në të dhënat personale të Regjistrimit të Gjendjes Civile.

Ndërkohë, në zbatim të Ligjit, konkretisht neneve 5, 27 dhe 28 të tij, sugjerojmë që në projektvendimet *“Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar (SMIP)”* dhe *“Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit të vlerësimit të maturës shtetërore (SVMSH)”* mbas pikës 7 dhe në projektvendimin *“Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit të provimit të shtetit (SPSH)”*, mbas pikës 8, të parashikohet një pikë, që rregullon *“masat e sigurisë dhe ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave”*, me përmbajtje:

“Palët do të ndërmarrin masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi. Çdo veprim në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave, etj, duhet të lerë gjurmë me qëllim garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave”.

Njëkohësisht, konstatohet se, në asnjë nga projektvendimet nuk janë përcaktuar afate për kohëzgjatjen e ruajtjes së të dhënave personale sipas parashikimeve të germës “d”, të nenit 5 të Ligjit. Sugjerojmë që mbas pikës 6 të projektvendimit *“Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar (SMIP)”* dhe të projektvendimin *“Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit të vlerësimit të maturës shtetërore (SVMSH)”*, si dhe mbas pikës 7 të projektvendimit *“Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit të provimit të shtetit (SPSH)”*, të shtohet një pikë, me përmbajtje:

“Të dhënat personale të transmetuara duhet të ruhen për aq kohë, por, jo më tepër sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin janë grumbulluar”.

Pas reflektimeve të mësipërme, projektvendimet mund të vlerësohen si të hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

